



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 2111/7 prot.

Tiranë, më 27.12.2024

REKOMANDIM

Nr. 45, datë 27.12.2024

PËR KONTROLLUESIN “XPERT SYSTEMS” SHPK

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Xpert Systems” SHPK (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 152, datë 29.09.2024 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, me fokus masat tekniko-organizative për përpunimin e tyre, veçanërisht sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI).

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT L51511023L dhe operon në fushën e IT dhe jo vetëm, duke ofruar shitjen e pajisjeve elektronike pc, laptop, monitor, printer, sistemet e sigurisë CCTV, sistemet e akses kontroll, sisteme UPS, dedektim zjarri etj., si instalimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë e të dhënave “punonjës”, “ klientë”, “vizitorë”, etj. Përpunimi i të dhënave personale kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi disponon një sistem video-survejimi CCTV për mbikëqyrjen e ambienteve të jashtme dhe të brendshme. Nga verifikimi i kryer në vend konstatohet se, Kontrolluesi nuk disponon tabelë informimi për mbikëqyrjen e ambienteve me sistemin CCTV, në kundërshtim me parashikimin e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit. Sipas Udhëzimit nr. 3, subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem video-survejimi është në veprim, duke vendosur në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejimit, të miratuar nga Komisioneri.

3. Kontrolluesi ka të publikuar rubrikën “Privacy Policy” në faqen web <https://xspert.al/>. Megjithatë, rezulton se informimi nga Kontrolluesi është në gjuhë të huaj dhe nuk është shterues në lidhje me qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje) etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është i rëndësishëm, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë, si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmbushja e këtij detyrimi nga Kontrolluesi mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Informimi sipas përcaktimeve të nenit 18 të Ligjit, duhet të aplikohet për çdo proces përpunimi të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, që kryen Kontrolluesi.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhënave personale nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, ka detyrim që të publikojë “Politikën e Privatësisë” dhe të informojë qartësisht subjektet e të dhënave, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash me kontrolluesin realizohet nëpërmjet faqes së internetit.

4. Kontrolluesi ka lidhur Kontratë prokurimi me palë të treta, të tilla si “FED Invest”, me objekt “...*Mirëmbajtje pajisjesh dhe shërbimesh në server room të Fed Invest*”.

Gjithashtu kontrolluesi ka lidhur kontratë me “Garda e Republikës” me objekt “...*Riparim pajisje të komunikimit dhe elektronikës*”.

Nga analizimi i kontratave me palët e tretë, rezulton se në përmbajtje të saj nuk janë reflektuar detyrimet sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*” i ndryshuar (në vijim, *Udhëzimi nr. 19*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave Kontrolluesi duhet të miratoj një akt/kontratë, që palët duhet të përdorin në rast të këtij delegimi, me anë të së cilës të garantojë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e tij me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të përpunuesit të jetë në përputhje me nenin 20 të Ligjit dhe me Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit.

Në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose shërbimit, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, nga analizimi i përmbajtjes së kontratës së shërbimit për “*Mirëmbajtje pajisjesh dhe shërbimesh në server room të Fed Invest*” të lidhura midis Xpert System (në cilësinë e ofruesit të shërbimit) me përfitues FED Invest, nuk specifikohen masat konkrete teknike-organizative të detyrueshme për tu zbatuar nga ana e Përpunuesit, me qëllim garantimin e sigurisë dhe përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale, si dhe nuk janë reflektuar detyrimet sipas parashikimeve në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave palët duhet të miratojnë një kontratë, me anë të së cilës, të garantojë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e kontrolluesit me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të përpunuesit, të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi, në mënyrë që të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave.

5. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit, si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar rezulton se Kontrolluesi nuk ka përmbushur detyrimin për njoftim mbi

përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim mbi përpunimin e të dhënave personale, është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe në realizimin e detyrimeve ligjore të këtij të fundit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre sipas Ligjit.

6. Kontrolluesi nuk ka hartuar rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash) sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, masat teknike dhe organizative etj., në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një rregullore specifike “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura teknike-organizative mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, (për çdo kategori subjektësh), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, duke mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu, konstatohet mosplotësim të detyrimeve në lidhje ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit, “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha” (në vijim “Udhëzimi nr. 47”).

Sipas parashikimeve të Kreut IV të Udhëzimit nr. 47, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky është një detyrim i vazhdueshëm i Kontrolluesit që personeli i subjektit përpunues të të dhënave personale të trajnohet rregullisht për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit nëpërmjet rrugës postare.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit gjatë seancës dëgjimore datë 25.11.2024, paraqiti pretendimet me shkrim mbi konstatimet e procesverbalit:

- *Lidhur me pikën 2 të procesverbalit përsa i përket mos informimit të subjekteve të të dhënave për sistemin e video – survejimit CCTV, Kontrolluesi pretendon se ka të vendosur një tabelë në formë sticker në ambientet të cilat janë të survejuara, kjo e vërtetuar dhe me foto.*

Zyra e Komisionerit vlerëson se, tabela e vendosur nga Kontrolluesi nuk është formati i miratuar sipas Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem video-survejmimi është në veprim, duke vendosur në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejimit, të miratuar nga Komisioneri.

- *Lidhur me konstatimin në pikën 3 të procesverbalit, se politikat e privatësisë në faqen online janë në gjuhën angleze, Kontrolluesi pretendon se faqja web e shoqërisë është një faqe web e ndërtuar e gjitha në gjuhën angleze, si rrjedhojë dhe politika e privatësisë do të ishte në gjuhën angleze.*

Zyra e Komisionerit vlerëson se, subjektet e të dhënave personale duhet të informohen në gjuhën shqipe për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, të drejtën për akses, të drejtën për fshirje dhe/ose korrigjim të të dhënave, etj në përputhje me nenin 18 të Ligjit.

- *Lidhur me konstatimin në pikën 5 të procesverbalit, Kontratat me palë të treta, Kontrolluesi pretendon se janë kontrata të hartuara nga ana e autoriteteve kontraktore dhe jo nga ana e Kontrolluesit, si subjekte të sektorit publik apo privat.*

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose një shërbimi, palët duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Detyrimet e përpunuesit për përpunimin e të dhënave personale, parashikohen në nenin 20 të ligjit dhe rregullohen me aplikimin e Udhëzimit nr.19.

- *Lidhur me pretendimin se nuk është hartuar një “Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, kontrolluesi pretendon se një rregullore e tillë është paraqitur me email grupit të inspektimit.*

Në lidhje me këtë pretendim, Zyra e Komisionerit vlerëson se, dokumenti i dërguar me postë elektronike nga Kontrolluesi me emërtimin rregullorë “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, nuk ka të parashikuara nene përkatëse për proceset, procedurat, masat tekniko-organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., lidhur me veprimtarinë e Kontrolluesit, në kundërshtim kjo me parashikimet e nenit 27 të Ligjit. Në përmbajtje të saj kjo rregullorë përmban nene që kanë të bëjnë më shumë me sistemin gjyqësor, dhe jo me fushën e veprimtarisë së Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, është i nevojshëm rishikimi i këtij akti ku të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (*për çdo kategori subjekti të dhënash*), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj. Kjo rregullorë duhet të jetë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale, në përputhje me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

- *Lidhur me masat konkrete të ndërmarra në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, Kontrolluesi pretendon se kemi vërtetuar me certifikatat e punonjësve me anë të të cilave vërtetohet se këta punonjës përse i përket pajisjeve për të cilat ne operojmë kanë marrë trajnimin e duhur dhe janë certifikuar, përse i përket aksesit dhe përpunimit të të dhënave personale.*

Zyra e Komisionerit vlerëson se, certifikatat e punonjësve nuk i përkasin trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 18, 20, 21, 22, 27, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/1”), si dhe 32 të ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të marrë masa për zbatimin e detyrimeve, në lidhje me informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit;

2. Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit me përpunuesit duke specifikuar detyrimet midis palëve, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
3. Kontrolluesi në zbatim të nenit 21 të Ligjit, të përmbushë detyrimin për njoftim mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, pranë Zyrës së Komisionerit;
4. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të marrë masa për të hartuar Rregullore specifike “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;
5. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale dhe krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale.
6. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
 - (i) vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikën 1 më sipër;
 - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 më sipër;
 - (iii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 4 më sipër;
 - (iv) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 5 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

7. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;
8. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 27.12.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi